POP 5
Lajmet me të lexuara të 5-minutave të fundit
1 Aventura e pasionit gërvisjen në kuqërisë! Pi bërin e'ka brenda makinës ne majë të shkëmbit, çifti brazilian vdes para rënies nga tarraxia
2 Alban Daci: Do të ishte e papranueshme që një pronar modhe në Shqipëri të pretendojnë nëse do t'i ngjante sadopak modelit të Berlusconiit!
3 Shkoi në fati me gruaren ne mashtro 16-vjeçare, tani është presidenti i parë shqiptar i Rotary-t. Historia e jashtëzakonshme e Klodian Matijas
4 Eduard Zaloshnja: Me kanale 1 me 100 për norton, Banka e Shqipërisë merr të sigurojë rezervë valutore për 12 muaj importe
5 Shqiptar të pjegosurit në Fier, Klajdi Mustaj qëllon Report TV: Institutet i ardhuri 2/e mendova dy herë, ndërhyra me fëmijën e zjarrit, më pas i ravitra nga makina

Kronikë

Tiranë/ Do shiste 2 pistoleta te grupet kriminale të Freskut, arrestohet në Allias 28-vjeçari me precedent penal (EMRI+VIDEO)

I riu nga Shkodra është person me precedent të mëparshëm penal për prodhim/shitje narkotikësh, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. ***Armët do të shiteshin për 3500 euro secila.***

■ Report Tv siguron foton, ky është Aleksandër Matoja që do t'u shiste grupeve kriminale pistoletat e ardhura nga Turqia

Redaksia
8 Gusht, 11:29 | Përditësimi: 8 Gusht, 14:41

Share

Policia e Tiranës ka goditur një rast të shitjes së armëve të zjarrit tek grupet kriminale.

Gjatë finalizimit të aksionit nga forcat e Komisariatit Nr.4, uniformat blu arrestuan në Allias 28-vjeçarin Aleksandër Matoja nga Shkodra, person me precedent të mëparshëm penal për prodhim/shitje narkotikësh, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal.

Ai u kap brenda makinës së tij, ku dhe u gjetën 2 pistoleta, të cilat dyshohet se do t'ua shiste anëtarëve një grupi kriminal që vepron në zonën e Freskut në kryeqytet.

LEXO EDHE:
Zbardhet plagosja e 27-vjeçarit në Tiranë, policia arreston 3 persona dhe shpall në kërkim 1 tjetër, shkak sherri për borxhin e pashlyer (EMRAT)

Gazetari i Report Tv, Sokol Dema, ka mësuar nga burime policore se armët ishin trafikuar nga Turqia dhe do të shiteshin për 3500 euro secila. Autoritetet dyshojnë se këto armë do të përdoreshin në ngjarje kriminale, megjithëse hetimet pritet të zbardhin të tjera.

Njoftimi i Policisë Tiranë:

Finalizohet operacioni policor i koduar "Black market". Sekuestrohen 2 pistoleta.

Arrestohet në Allias, një 28-vjeçar, banues në Shkodër, që dyshohet se do t'ua shiste armët e zjarrit, shtetasve që kryejnë krime kundër jetës dhe pronës.

I arrestuari, shtetas me precedent penal, si pjesëtar i një grupi kriminal në Shkodër.

Në vijim të kontrolleve dhe punës intensive operative të Policisë së Tiranës, me fokus kapjen e shtetasve që lëvizin të armatosur dhe për pasojë, janë rrezik potencial për rendin dhe sigurinë e qytetarëve, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 4 finalizuan operacionin "Black market".

Gjatë operacionit u arrestua në flagrancë shtetasi A. M., 28 vjeç, banues në Shkodër, me precedent për prodhim/shitje narkotikësh, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal.

Nga kontrolli në automjetin me të cilin ai lëvizte në Allias, u gjetën 2 armë zjarri pistoleta, të cilat dyshohet se do t'ua shiste shtetasve që kryejnë krime kundër jetës dhe pronës.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Aleksander Matoja

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:39

Report Tv siguron foton, ky është Aleksandër Matoja që do t'u shiste grupeve kriminale pistoletat e ardhura nga Turqia

Gazetari i Report Tv Sokol Dema ka siguruar foton e Aleksandër Matoja, 28-vjeçarit të arrestuar që do të shiste dy pistoleta në zonën e Freskut në Tiranë për anëtarët e një grupi kriminal që vepron në zonë.

Matoja u arrestua në zonën e Alliasit gjatë një aksioni të efektivëve të Komisariatit Nr.4 në kryeqytet.

Aleksandër Matoja me origjinë nga Shkodra është person me precedent të mëparshëm penal për prodhim dhe shitje narkotikësh në kuadër të grupit të strukturuar kriminal.

Ai u kap me 2 pistoleta, të cilat do t'i shiste për 3500 euro secilën.

V.GJ /Shqiptarja.com

Share

V.GJ /Shqiptarja.com

TAG: shitje armësh | aleksander matoja | Tirane

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM
Sondazhi i ditës:
A po i liron hapësirat publike aksioni i qeverisë?
7 Gusht, 10:03
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Policia rrethon News24, kërkon trim të godinës! Televizionit i fiket sinjali. Opozita e shoqatat: Sulm fjalës së lirë/ Avokatura e Shtetit: I ka përfunduar kontrata e qirasë
9 Gusht, 10:25

7 vatra zjarri aktive në vend, problem situata në Fieri, shmanget rreziku për banesat në fshatin Livinë
9 Gusht, 09:25

Plagosje me armë zjarri në Tiranë, 27-vjeçari paraqitet në spital me dëmtime në këmbë (EMRI)
9 Gusht, 06:57

Ndodh çudia në kryeqytet, 45-vjeçari i vë traun e hekurit sheshit para pallatit dhe s'lejon banorët që të parkojnë mjetet
8 Gusht, 14:58

Report Tv siguron foton, ky është Aleksandër Matoja që do t'u shiste grupeve kriminale pistoletat e ardhura nga Turqia
8 Gusht, 14:39

Masa shtrënguese për 'Shtëpitë Funerale': Jo në godina të banuara dhe as të dukshme për publikun
8 Gusht, 13:24

SPAK godet sërish grupin e Çogjave: Ndër më të fuqishmit në trafikun e kokainës, ndikonin çminin në Evropë! Iu kapën 17 ton kokainë, sekuestro 14 pronave! 10 të arrestuar e 6 në kërkim (EMRAT)
Keti Banushi
8 Gusht, 12:33

Shkolla 9-vjeçare 'Angela Merkel' në Kamëz, Rama: Krenar për shkollat e gjeneratës së re që kemi ndërtuar
8 Gusht, 11:48

I humbi të vëllait në Dhërmi, 27-vjeçari nga Tirana kthehet në banesë pas një jave 'pa gjurmë'!
8 Gusht, 11:48

Ilir Meta kërkon lirinë, shtyhet seanca në GJKKO! Gjyqtari Bani shpalli moskompetencë. Avokati Cakrani: Kërkojmë gjyqtarin e çështjes, Erjon Çela
8 Gusht, 07:29

Kompjuter në shtëpi, kryesojnë Tirana dhe Korça! Bashkitë e vogla ende larg teknologjisë
7 Gusht, 19:51

Lirimi i hapësirave publike në Tiranë, nënkryetari Sulaj: Sipërfaqet do t'u kthehen qytetarëve, marrim masa për zaptuesit
7 Gusht, 14:19

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasuriorizuar i kësaj faqeje